



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/03-31550 /2018
Kaçanik, 27.09.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 27 Shtator 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës –Ylber Bajra dhe 7 drejtorët e drejtorive komunale (Zahir Doda, Fatmir Loku, Festim Neziraj, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Bahri Selimi dhe Diana Reka).

Nga zyrtarë komunal ishin: Ilir Lumi dhe Bajtulla Dalloshi.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, fillimisht në emër të KK, z. Bekim Koxha ia uroj Ditëlindjen, e konstatoj kuorumin emër për emër, ndërkaq në vazhdim e hapi mbledhjen e IX (Nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 27 Shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimet për vitet, 2020-2021;
3. Propozim Vendimi për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018;

4. Propozim Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfytëzim afatshkurtër;
5. Propozim Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas PZHK për parcelën kadastrale Nr. 516-1, Zona Kadastrale, Kaçanik;
6. Propozim Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 350/02- 21705/18 – për rishqyrtimin e Planit zhvillimor komunal për Komunën e Kaçanikut; dhe
7. Informatë e DAK, për fillimin e vitit shkollor 2018/2019.

Rendi i propozuar i punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendi i Punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VIII (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së 8 të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, e;

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e 8 (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 31 Korrik 2018/ Lënda 01Nr.060/03-23740/2018.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, lidhur me pyetje të ngritura nga KK në mbledhjen e kaluar, për të cilat KK nuk ka marrë përgjigje, kërkoi nga ekzekutivi i komunës të japin përgjigje, ndërkaq konstatoj me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Shpend Krusha,

1. Në emër të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut, kam një Kërkesë për DSHPE, që të merren veprime të nevojshme me kompaninë aksionare "Stacioni i Autobusëve "për pajisjen e stacionit të autobusëve me Tualet, pasi ka shumë njerëz që udhëtojnë me autobus të cilët presin 2 apo 3 orë në stacion.

2. A ka ndonjë përgjigje nga Qeveria e Republikës së Kosovës, lidhur me Kërkesën të cilën e kemi bërë në emër të KK, për ndërtimin e një: Kyçje-Ç kyçje në afërsi të Kaçanikut në Autostradën "Arbër Xhaferi", A ka ndonjë përgjigje për Kërkesën në fjalë së deri ku ka arritur procedura për këtë çështje.

z. Adnan Reka,

Meqenëse sot kemi për të votuar projekt buxhetin e komunës, dhe ju nuk keni marrë parasysh Kërkesat tona, unë kam disa kërkesa:

1. Rregullimi i një fushe të basketbollit dhe vendosjen e disa tabelave të Pingpongut nga betoni të përshtatshme për parqe, që do ta gjallëronin parkun e qytetit.

2. Para disa muajsh DUKMM përmes Kuvendit vendosi që Tregun e Gjelbërit ta vendosë përkohësisht në hapësirat e Kalasë së qytetit, e më pastaj në një lokacion tjetër afër Voskopojës, që nuk plotëson as kushtet minimale për një veprimtari të tillë. Prandaj kërkojmë që, Tregu i gjelbër të vendoset në pronën publike afër bustit, Idriz Seferit, të rregullohet infrastruktura e përshtatshme me asfalt apo kubëza betoni, të jetë i mbuluar dhe i pajisur me tezga vetëm për shitës të pemëve, perimeve dhe produkteve të qumështit. Ky projekt modest do të eliminonte shitësit ambulant të pemëve, perimeve dhe bulmetit, si dhe do t'i rregullonte këtë pjesë të qytetit. Projekti në fjalë do të ishte mobil dhe në rast se do të parashihej ndonjë plan ambicioz në të ardhmen, atëherë ky treg do të mund të zhvendosej kudo pa humbur asgjë.

3. Pasi, jemi në prag të stinës së reshjeve atmosferike, Kërkojmë nga DSHPE që në rrugën 'Sali Bajra' me saktësisht përballë objektit të Çerdhes së Fëmijëve të rregullohet. Kanali i ujërave atmosferike dhe fekale i cili është total i bllokuar, kundërmon, dhe pas çdo reshje lëvizja e qytetarëve të asaj lagje bllokohet tërësisht.

4 Pyetje për Kryesuesin e Komitetit për Shërbime Publike-Hamid Gurin. A e ka ndër mend me na ftuar në ndonjë takim të këtij komiteti, që të mund të diskutojmë për gjëra që jemi të thirrur, sepse nga data e zgjedhjes së tij, nuk jemi ftuar në ndonjë takim të këtij komiteti.

Kryesuesi i Kuvendit, Jo vetëm Komiteti për Shërbime Publike, por si duket të gjitha Komisionet e Kuvendit të Komunës nuk janë funksionale.

znj. Nazife Krasniqi, Trafoja afër shtëpisë së Halim Krasniqit, kur ka filluar me u ndërtuar objekti, ka pasur me u hequr, ndërkaq nuk është marrë asnjë veprim në këtë drejtim deri me tani. Kërkesën e kam me shkrim në emër të qytetarëve të lagjes për me marrë veprime të nevojshme me u largua trafoja në fjalë.

zjn. Lirije Shurdhani, Në emër të qytetarëve të f. Bob kam një Kërkesë që të epët një përgjigje, përse nuk kanë lilluar punimet në rrugën "Muhamet Zeneli" rrugë kjo afër shkollës së f. Bob. Kërkoj nga organet përkatëse që të nisin punimet e kësaj rruge, kur dihet fakti se, kjo rrugë ka qenë në projekt me prioritet.

z. Bekim Koxha, Për herë të parë kam marrë përgjigje me shkrim nga DUKMM lidhur me Kërkesat të cilat i kam ngritur. Disa sqarime janë dhënë nga drejtoria, ndërkaq për disa tjera, përgjigjet nuk janë të mjaftueshme. Të Tregu i Gjelbër i cili iu ka dhënë kompanisë, a ka pasur procedura dhe në bazë të cilave akte iu është dhënë kompanisë dhe çka përfiton komuna.

znj. Afërdita Shehi, Në emër të qytetarëve të f. Biçec, me intereson të di, a është në projekt me prioritet, Ndriçimi publik në f. Biçec.

z. Besim Vishi,

1. Punët që po kryhen aty te Parku në hyrje të qytetit, është mirë të koordinohen me ekipet e KEDS-it, për arsye se aty kalon një kablo tokësore tepër e dëmtuar, paraprakisht sa kam punuar ne KEDS, kam pas bërë skicimin e shtrirjes se kabllos të ri, dhe i rekomandoj punë kryesit të koordinohen me KEDS-in që të bëjnë ndërrimin e kabllos para se të shtrohet asfalti aty mbi kabllo e vjetër, në mënyrë që mos të vije deri te prerja e asfaltit pastaj.

2. Projekti i trotuarit me kubëza nga shkolla e Dubravës deri Imisht, kërkoj që mos të bëhet ngushtimi i asfaltit ekzistues me arsyen që të realizohet gjerësia e trotuarit prej 1.20m, sepse ngushtimi i asfaltit do të ndikonte në aksidente të shpeshta në këtë rrugë të shumë frekuentuar. Më mirë është të ngushtohet gjerësia e trotuarit aty ku është e nevojshme sesa të ngushtohet asfalti kryesor. Nëse është mundësia të shqyrtohet edhe një herë çështja e realizimit të projektit të trotuarit të asaj rruge.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kërkesa të tjera, atëherë konstatoj me kaluar në pikën e radhës, ndërkaq përgjigjet në Kërkesa do t'i merrni nga ekzekutivi i komunës. Në vazhdim kalojmë në pikën vijuese:

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimet për vitet. 2020-2021:

Kryesuesi i Kuvendit, Theksoj se për Buxhetin e Komunës të vitit 2019 dhe projektimet buxhetore 2020-2021 janë mbajtur Dëgjime Publike edhe nga KPF dhe KK, gjithsej 4 dëgjime. Në vazhdim kryesuesi i potencoj datat kur janë mbajtur dëgjimet buxhetore, pjesëmarrësit nga OJQ, grupet e interesit dhe qytetarë etj. Proceset kanë qenë të frytshme, ku kanë marrë pjesë bukur shumë pjesëmarrës, janë edhe Procesverbalet e dëgjimeve dhe kur të përpilohen nga shërbimet do t'i publikojmë në Faqen zyrtare të komunës. I falënderoj ekzekutivin e komunës që kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë kontributin në këto debate dhe kanë marrë parasysh shumë kërkesa të dala nga këto debate. Para se me hapur diskutimin, fjalën ia jap fillimisht Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Theksoj se lidhur me Buxhetin e Komunës për vitin 2019 dhe projektimet buxhetore 2020-2021 janë organizuar dhe mbajtur shumë debate publike me qytetarë të komunës. Debate publike për buxhetin janë mbajtur nga muaji qershor e deri para miratimit final të buxhetit.

Kërkesat të cilat kanë qenë të arsyeshme, mbi 90% të tyre jemi munduar me i përfshirë në buxhet, meqë është e pamundur të përfshihet çdo kërkesë sepse buxheti është i limituar. Ajo që tha z. Adnani Reka, kjo nuk me ka rastisë, përndryshe është një kërkesë simbolike, dhe kjo mund të kryhet. E kemi paraparë të nevojshme investim infrastrukturor në dy shkolla, gjë që mundet me zbutur gjendjen e nevojave të shkollave. Kërkesa ka pasur nga të gjitha subjektet politike. Pra sivjet jemi munduar me i futur ne Buxhet të gjitha ato kërkesa të të gjitha subjekteve politike cilat kanë qenë të arsyeshme. Në dëgjimin e fundit, unë kam kërkuar të Investimet Kapitale që nëse ju e shihni që një projekt nuk është në prioritet e heqim dhe e fusim një projekt që është me tepër me prioritet dhe nuk kemi pasur ndonjë rekomandim me përjashtim që kemi pasur 2-3 kërkesa të tjera të cilat i kemi futur si kode dhe kështu besoj se kemi arritur me i futur shumicën e kërkesave që janë më të arsyeshme, me shpresë që të arrijmë t'i realizojmë edhe projektet e koduara me ndihmën tonë dhe të çdonjërit nga ju që ka ndikim në nivelin qendror apo diku tjetër.

z. Bahri Selimi, Sqaroj për procedurat e buxhetit, dokumentet buxhetore duke u nisur nga Qarkoret buxhetore, ndryshime, burimet e financimit, grantet, strukturën e buxhetit.

Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2019 është në shumë, 8,381,634.00 €, në vitin 2020-vlerësimet e projektuara janë në masë monetare, 8,651, 903.00 € si dhe për vitin 2021-8,964,018.00 €. Në vitin 2019 do të ketë rritje për 8.32 % apo 600 mijë € më shumë se në

vitin 2018. Shpenzimet buxhetore për vitin 2019, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, parashikohet të kenë këto ndarje të cilat janë në përputhje të plotë me Qarkoren Buxhetore 2019/02 të Ministrisë së Financave. Shpenzimet për Paga dhe Mëditje janë, 5,102,663.00 €, Mallra dhe Shërbime; 900,000.00€, shpenzimet e shërbimeve Komunale; 160,000.00 €, Subvencionet dhe Transferet 206, 540.00 € si dhe Shpenzimet në Investimet Kapitale 2,012,431.00 €. Në vazhdim drejtori sqaroi edhe për krahasimet buxhetore të cilat janë bërë me dy vitet e fundit, aty ku janë bërë ngritje etj. duke sqaruar secilin pozicion veç e veç. Nëse bëjmë krahasime të buxhetit vit pas viti, buxheti nga fillimi e deri me tani ka pësuar ndryshime buxhetore për investime.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjoi sqarimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të DEFZH, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Në LVV e kemi mbajtur një takim me subjektin politik për çështjen e Buxhetit 2019 dhe konsiderojmë që buxheti për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimi për vitet 2020 dhe 2021 është buxhet elektorale dhe nuk garanton zhvillim ekonomik. Shikuar sipas territorit dhe proporcionalisht ndarja e buxhetit të investimit kapitale është e padrejtë dhe diskriminuese. Investimet në, Bujqësi, Zhvillim ekonomik, Shëndetësi dhe Kulturë, Rini dhe Sport mbesin të ulëta. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve mbetet prioritet i kësaj Qeverie me 48% të investimit kapitale.

Në mbledhjen e Kuvendit në muajin qershor kemi propozuar dhjetëra kërkesa që të futen në Kornizën Afatmesme Buxhetore, dy prej të cilave u futën në buxhet si kod – Projektimi dhe ndërtimi i impiantit të përpunimit të ujërave të zeza dhe Renovimi i brendshëm i Shtëpisë së Kulturës.

Nga Dëgjimet Publike që patëm me grupe të interesit dhe qytetarë të komunës, u paraqitën shumë kërkesa nga ana e tyre, ndërkaq nuk shoh që kërkesat e tyre janë inkorporuar në buxhet. Prandaj, Lëvizja Vetëvendosje do të abstenoj kur buxheti të dal në votim për aprovim.

z. Bekim Koxha, Edhe subjekti politik i NISMA, në bazë të analizës dhe mendimit të kryesisë, kemi vendosur që mos të aprovojmë këtë Buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit, Është mirë që vendimet e Kryesisë së partive mos me na i sjellë këtu. Ne jemi duke folur për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për qytetarët e komunës së Kaçanikut dhe nuk është mirë me na treguar vendimet politike të cilat i keni marrë. Për mua janë të papranueshme vendimet e subjekteve politike të cilat i prezantoni këtu për çështje të buxhetit të komunës.

z. Selim Reka, Vet mënyra e paraqitjes së buxhetit është e qartë. Nga Buxheti shihet se ka ngritje të pozicionet Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime, ndërkaq të pozicioni i Subvencioneve dhe Transferove, nuk kemi dallime nga viti 2018. Buxheti për Investime Kapitale shihet se nuk është i madh karshi kërkesave dhe nevojave të komuniteteve, ndërkaq vërejtjet tona janë të shpërndarja buxhetore. Të investimet kapitale ka qenë një Kërkesë për trajtimin e ujërave të zeza. por nuk ka kaluar kjo kërkesë. Nga projektimet buxhetore shihet se qyteti i Kaçanikut është përfshirë shumë pak në investime kapitale. ndërkaq dihet se buxheti për IK ndahet për kokë të banorit.

z. Nexhat Loku, Ne kemi mbajtur disa takime publike me qytetarë. Investimet kapitale janë mbi 1 milion €. Buxheti ndahet për kokë banori, shpërndarja është bërë në formë profesionale, kështu ne do ta mbështetim.

z. Ekrem Raka, Edhe unë pajtohem me mendimin e subjekteve politike në opozitë, sepse kanë kaluar gati 20 vite pas luftës në Kosovë dhe ne ende merremi me asfaltimin e rrugëve. Unë në buxhet nuk po e shoh se është përfshirë, Ndërtimi i Sallës së R e të Kuvendit të Komunës. Nëse e lexojmë me shifra buxhetin e komunës, të lënë hapësirë me dyshuar se kemi shpërndarje partiake të buxhetit. Ndërsa në sistemin demokratik, buxheti duhet të ndahet në formë të drejtë për të gjithë qytetarët.

Kryesuesi i Kuvendit, Renovimi i Sallës së KK nuk ka hyrë në prioritet, sepse do të realizohet me një grant të MAPL, ajo është përfshirë në buxhet vetëm sa për t'u koduar,

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Unë jam Kryetar i Komunës i të gjithëve qytetarëve pa përjashtim dhe iu kujtoj se unë nuk kam mbajtur mbledhje të partisë për çështje të buxhetit. Në debate publike të organizuara, nuk ka pasur vërejtje nga ndonjë subjekt politik që me hequr apo me futur ndonjë projekt.

Kur jemi të fshatrat që po thuhet se kanë shkuar prioritetet, ka nxënës të shkollave në fshatra që ecin 2 km nëpër baltë. Me thoni ju mua, cilin projekt që është me prioritet jeni të pajtimit të hiqet në fshatra e të futet një projekt me prioritet në qytet. E përmendi z. Selim Reka, çështjen e ujit të pijes, është prioritet, po është e vërtetë, unë e kam lënë si kod, por nuk kemi projekt për ujën. Unë kam kërkuar nga kompania me na bërë një projekt sepse ne nuk kemi kapacitete, nuk kemi mjete dhe në momentin që ta kemi projektin ne do të kërkojmë mjete për realizimin e projektit. Të trajtimi i ujërave të zeza, 25 milion kushton vetëm për Kaçanik, ndërkaq veç projekti kushton diku 7-8 mi euro dhe ju i dini kapacitetet tona dhe unë jam duke u munduar me gjetur një kompani me na i bërë projektin, ndërkaq trajtimi i ujërave të zeza nuk mund të bëhet pa gjetur edhe donacione nga OJQ dhe këtë e dini edhe ju, por çështja është si opozitë me thënë diçka. Me thoni mua subjekti opozitë se, cilin projekt e keni propozuar e nuk ka hyrë në listë. Në shtëpinë e Kulturës kemi investuar para dy viteve dhe e kemi përmyllur projektin, do t'i japim prioritet përsëri kur t'i vjen momenti. Kemi investuar edhe në ujësjellës, ndërkaq tani prioritet iu kemi dhënë shkollave ku mëson nxënësi për 9 muaj, kur dihet gjendja e SHM profesionale dhe e shkollës në f. Doganaj, ndërkaq dhe Shtëpisë së Kulturës do t'i japim prioritet. Ka pasur Kërkesë edhe z. Bekim Koxha për prioritet dhe e kemi futur propozimin e tij në prioritet. Me thoni cili nga projektet nuk është në prioritet, e heqim dhe e fusim një që mendoni së është më me prioritet. Duhet ta keni parasysh faktin se Buxheti i Komunës për vitin 2019 dhe projeksionet për vitet, 2020-2021 nuk është elektoral, ndërkaq 70% e kërkesave tuaja janë të përfshira në këtë buxhet.

z. Ekrem Kyçyku, Unë nuk ka asgjë kundër asfaltimit të rrugëve, por të bëhet një trotuar i rrugës, Bob - Doganaj, kujtoj se është i rangut të dytë në raport me prioritetet tjera. Disa Kërkesa të cilat i kam propozuar në emër të LVV kanë hyrë në buxhet, por jo të gjitha.

z. Adnan Reka, Unë mendoj se ky Projekt Buxhet është diskriminues dhe më shumë i ngjan një buxheti elektoral që ka për qëllim të vetëm, votën. Diskriminues është për faktin se; po ta marrim, Drejtorinë e Shërbimeve Publike ku janë paraparë 795,000 euro; 730,000 euro shkojnë kryesisht në ndërtimin e rrugëve dhe rrugicave nëpër fshatra të komunës sonë, dhe vetëm 65.000 euro shkojnë për investime në qytet, dhe atë në projekte të pa definuar çartë.

Unë themi të paktën barazojnë qendrën administrative me një fshat të madh, ku banorët e atij lokaliteti paguajnë pak taksa administrative, ama, mos e barazoni me fshatra tepër të vegjël të cilët nuk paguajnë taksa fare. Fundi fundit edhe buxheti i shtetit për komuna ndahet për kokë banori, gjë që i bie se në Kaçanik si qendër administrative do të duhej të investohej 1/3 e buxhetit komunal në proporcion me numrin e banorëve, e pastaj po t'ia shtojmë edhe faktin se në Kaçanik si qendër administrative marrin shërbimet gjithë banorët e Komunës pa dallim, sigurisht që do të duhej të ishin investimet shumë më të mëdha. Cila është logjika e tatimit me të madh, sepse tatimi i qytetarëve duhet të iu kthehet në projekte.

z. Bekim Koxha, Të projekti i rrugës i cili u potencua, unë kam kërkuar me hyrë në prioritete, unë kam kërkuar jo si Bekim, por në emër të qytetarëve të fshatit, sepse është nevojë me u ndërtuar ajo rrugë. Gjithashtu të zhvillimi i sektorit të bujqësisë, kam kërkuar shtrimin me zhavorr të rrugës për të Stanet, por kjo nuk u realizua. Nga projektimet buxhetore, shihet se 48% e mjeteve të Investimeve Kapitale kanë shkuar për infrastrukturë rrugore, ndërkaq për bujqësi nuk ka investime.

Kryetari i Komunës, Janë do kritere të cilat i përcakton dikush tjetër, dhe ato kritere duhet me u zbatuar. Thuhet se 48% e mjeteve nga IK kanë shkuar për rrugë, ndërkaq ju vet keni kërkuar investime në rrugë, edhe për rrugën të stanet kam investuar. Edhe prioritete në Kaçanik kemi përcaktuar, ndërkaq të çështja e trotuarit të rrugës: Bob - Doganaj, iu kemi dhënë prioritet, sepse rrezikohen nxënësit. 14 prioritete i ka sjellë LDK dhe të gjitha ato projekte i kam dërguar në ministri. Rrugët e papërfunduara në qytet, sivjet do të përfundojnë. 70% të Kërkesave që i kanë propozuar subjektet politike janë këtu në buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit, Me shikuar nga janë taksapaguesit, ka fshatra të cilat janë të vogla dhe fjala vjen a mos me investuar në asnjë projekt atje. Ne mendojmë që e para që duhet me iu siguruar kushte qytetarëve të komunës, është çështja e sigurisë.

Vendi nga vijë unë që 4 vite ka investuar mbi 100.000€ i kanë dhënë fshati në hartimin e projekteve (si në projektin e ujësjellësit dhe të kanalizimit) dhe shumë projekte të tjera të vogla i kanë realizuar me mjete të tyre, kështu nuk guxojmë të bëjmë këtë krahasim, sepse aty ku është nevoja duhet të investohet, se edhe ne kemi lehtë sepse na nga thonë se po i bëjnë disa projekte me mjete të veta. Ndriçimi publik në 4-5 vende është bërë me bashkëfinancim.

z. Ekrem Kyçyku, Nuk kemi asgjë kundër investimeve në fshatra, por ne e patëm fjalën për një fushë sportive të parku i qytetit e cila do të jetë në shërbim të qytetarëve e jo të nxënësve. Të trotuari, ka fshatra ku është rregulluar trotuari i rrugës, por janë mbushur me bari. Unë në këtë buxhet, nuk e shoh se janë futur të gjitha kërkesat të cilat i kemi ngritur në muajin qershor kur është aprovuar korniza buxhetore.

z. Selim Reka, Çështja e prioriteteve është ngritur edhe në mbledhje të KPF, rruga për në f. Gajre e cila është dëmtuar, dihet se i takon kompanisë, "Bektel Enka "për me rregulluar, ashtu është Marrëveshja, ndërkaq mjetet e parapara për atë rrugë, unë mendoja me i orientuar në prioritete tjera.

Kryetari i Komunës, Nuk është fjala se ka me u shtruar rruga e Gajrës me mjetet e parapara, por disa pjesë nga kjo rrugë në disa lagje që janë me në thellësi të cilat i ka dëmtuar kompania " Bektel Enka".

Kryesuesi i Kuvendit, Komuna e Kaçanikut ka shumë nevojë për projekte kapitale, por mendohen të financohen nga ministria, sepse komuna nuk ka mundësi financimin e tyre. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë Buxhetin e Komunës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 16 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 11 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimet për vitet, 2020-2021 / Lënda: 01Nr. 400/01-28721/18.

3. Propozim Vendimi për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i Financave, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Sqaroj se është hera e dytë në këtë vit buxhetor që bëjmë ridestinim dhe rialokim të mjeteve buxhetore të vitit 2018, kjo për shkak se në vitin 2018 nuk kemi pasur Rishikim Buxhetor. Arsyeja e ridestinitimit të mjeteve në sektor të caktuar, është se kemi shumë obligime të DAK si të pensionimi i arsimtarëve të cilët iu takojnë kompensimet shtesë pas pensionit dhe disa nevoja të tjera. Në vazhdim drejtori i sqaroj edhe ridestimet tjera ashtu si janë paraqitur në tabela dhe i dha arsyet pse po bëhen këto ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri nga anëtarët të cilët ishin prezent. Në kohën kur u aprovua kjo çështje, nuk ishin në sallë anëtarët: Lirije Luta, Shemsedin Luzha, Shpend Krusha, Pranverë Loku –Zharku dhe Hajredin Luta. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018 / Lënda: 01Nr. 400/01-31236/18.

4. Propozim Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër;

Kryesuesi i Kuvendi, Theksoj se kësaj prone njëherë iu ka ndërruar destinimi, mirëpo me vonë sipërfaqja ka ndryshuar për shkak të rrugës dhe një pjesë të saj është bërë kanali i ujitjes, kështu që ai i cili e ka marrë në shfrytëzim atë pronë, në pamundësi të shfrytëzoj tërë sipërfaqen, ndërkaq pagesën me bërë për tërë sipërfaqen, është tërheqë nga Ankandi Publik. Nisur nga kjo, DUKMM ka bërë Propozim Vendim që të epet në shfrytëzim vetëm ajo pjesë që mund të jetë e shfrytëzueshme për Treg të Kafshëve. Nëse miratohet ky Propozim Vendim, atëherë shkon në procedurën e Ankandit Publik nga Komisioni i KK për Dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, pastaj kjo çështje vjen edhe një herë në KK për marrjen e Vendimit përfundimtar.

Për këtë pikë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfytëzim afatshkurtër, në Zonën Kadastrale Kaçanik, ngastra kadastrale Nr.5-0 në sipërfaqe, 3885m² / Lënda: 01Nr. 104/02-30935/18.

5. Propozim Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas PZHK për parcelën kadastrale Nr. 516-1, Zona Kadastrale, Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Sqaroj përse kjo çështje i është adresuar edhe një herë KK. Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Theksoj se bëhet fjalë për një leje të përkohshme .Ne nuk kemi mundësi as me shpronësuar e as me e realizuar at plan zhvillimor në atë pjesë e me bërë gjelbërim. Ndryshimi i destinimit të kësaj prone kanë efekte pozitive, sepse ndikon në ekonominë e vendit. Pala e ka sjellë edhe një Deklaratë të vërtetuar nga Noteri, ashtu që nëse komuna ka interes të realizoj destinimin e PZHK për ngastrën kadastrale, ai nuk do të paraqes problem. Komuna e Kaçanikut nuk ka prona komunale në njërën anë, ndërkaq ka nevojë për zhvillimin e ekonomisë së vendit, nëse na ofrohet ndonjë investitor. E vetmja pronë ku mundet me bërë diçka në komunën tonë është kjo pronë, por nëse ne i qesim pengesa investitorit i cili na ofrohet, atëherë ai nuk e realizon investimin në komunën tonë. Ne nuk kemi mundësi atë pronë me e shpronësuar e as me realizuar me PZHK që midis qytetit me bërë gjelbërim, kështu unë kujtoj se duhet t'i hapim rrugë një investitori që të investoj në atë parcelë.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, A bëhet fjalë për pronën për ballë Shtëpisë së Kulturës “ Xheladin Kurtaj” në Kaçanik? Nëse mendoni së është e ligjshme marrja e këtij vendimi, ne subjekti politik i LDK-së do ta votojmë Për.

z. Shpend Krusha, A jeni sigurt se kjo çështje ligjërisht është në rregull. Nëse jeni të sigurt se ligjërisht kjo çështje është në rregull, atëherë edhe ne jemi që t'i hapim rrugë investitorit me investuar në atë parcelë.

z. Bekim Koxha, Kjo çështje që dy herë i adresohet KK. Kuvendi i Komunës ka marrë vendim njëherë lidhur me këtë pronë dhe MAPL e ka kthyer atë vendim të kundërligjshëm. Unë mendoj se këtu nuk është diçka në rregull dhe mua po me duket se ka shkelje ligjore dhe vendimi i KK ka mundësi të kthehet përsëri.

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i DUKMM i ka pasur disa takime me ministrinë e MMPH, dhe e ka marrë konfirmimin se çdo gjë është në rregull.

z. Ukshin Qallaku, Plani Hapësinor ka kaluar nga Ministria e MMPH, ndërkaq ata ligjin po e interpretojnë si po donë vet. Ligjërisht nuk kanë pasur të drejtë me na e kthyer vendimin Ministria as atëherë kur e ka kthyer, kur dihet fakti se Kapitulli V.I. e lejon një ndryshim të tillë, pasi që Rishikimi i PZHK bëhet në çdo 5 vjet, por rishikimet dhe ndryshimet eventuale

mund të bëhen edhe në periudha të tjera kohore, varësisht nga kërkesat dhe vendimet politike.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me dy votë Abstenime (Bekim Koxha dhe Hafize Sallahu). Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndryshimin e destinimit sipas PZHK për parcelën kadastrale Nr. 516-1, Zona Kadastrale, Kaçanik, në pronësi të Mevlude Dushkaja / Lënda: 01Nr. 104/02-31499/18.

6. Propozim Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 350/02-21705/18 – për rishqyrtimin e Planit zhvillimor komunal për Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Theksoj se Qeveria insiston në atë që të bëhet PZHK për shkak të ndryshimeve të mëdha që janë bërë me ndërrime të destinimeve dhe për shkak të ndryshimeve që janë bërë për shkak të ndërtimit të Autostradës, kështu duhet me filluar me hartimin komplet të ndryshimeve të PZHK.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk ka kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati. Abstenuan 5 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 350/02- 21705/18 – për rishqyrtimin e Planit zhvillimor komunal për Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-31498/18.

7. Informatë e DAK, për fillimin e vitit shkollor 2018/2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqatime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DAK, Zahir Doda.

z. Zahir Doda, Informata është e shkurtër, e saktë dhe reale. Një risi që është vërejtur në këtë vit të ri shkollor, është se numri i nxënësve të rexhistriuar në klasë të parë është më i madh sesa në 10 gjeneratat e fundit. Në Gjimnaz dihet se për shkak të defekteve- punimeve të cilat janë duke u realizuar, nuk ka filluar ende mësimi. Tani punët janë në përfundim e sipër dhe mësimi do të filloj të hënën, ndërkaq për zëvendësimet do të bëjmë plan sesi kanë me u realizuar.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit të DAK, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Me vjen mirë që është marrë vendim që të hënën me filluar mësimi në SHM “ Skëndërbeu”, se më të vërtetë u bë tepër kjo punë. Në këtë rast, përgjegjësia është

në trekëbndësh: Kryetar, Drejtori dhe Drejtor shkolle. Me intereson të di në disa shkolla të cilat e kanë numrin e nxënësve shumë të vogël, a po ka mundësi me u zhvilluar mësimi i kombinuar.

z. Adnan Reka, E përgëzoj drejtorin e DAK për përpjekjet e tija për të vendosur rend dhe rregull nëpër shkolla të komunës. Krahasuar me vitin e kaluar kur u dënuan shumë mësimdhënës (50) shumë drejtorë të Shkollave të Komunës sonë nga inspektorët shtetërorë të arsimit, sot kemi një gjendje më të mirë nëpër shkolla si rezultat i përpjekjeve tuaja. Ngecjet e punimeve nëpër shkolla ndonëse në drejtorinë tuaj për çfarë mbaheni përgjegjës, mendoj se tejkalojnë nivelin e autoritetit tuaj. Vonesat e punës së gjimnazit ‘Skënderbeu’ nuk mund të justifikohen nga një operator, ngase pasojat janë shumë të mëdha. Premtimet elektorale dhe pas elektorale se këtë shtator shkolla e re në Kovaqec do të filloj punën, doli të jetë e pa saktë, e arsyet mbase edhe korruptive mund t’i dinë ata që merren me tenderë, apo e kontrollojnë prokurimin. Unë dua të di, përse u ndërpreu punimet në shkollën e Kovaqecit dhe si anëtarë i këtij Kuvendi kërkoj të na dërgoni para-masat dhe parallogaritë dhe kontratën e këtij tenderi.

z. Selim Reka, Informata është reale, ndërkaq në shkollën e mesme “Skënderbeu” është e vërtetë se mësimi është vonuar me filluar, por nuk është menduar se do të zgjasin punimet aq shumë, mirëpo dihet se ka depërtuar një kompani që nuk e ka merituar të merr punë aty. Nganjëherë edhe pse kompania e jep çmimin e ulët, duhet me shikuar performancën qysh e ka. Orët e humbura të zëvendësohen, plani është bërë nga drejtori. Një punë e mirë është bërë në rehabilitimin e asaj shkolle, shpresoj të bëhet në të ardhmën edhe në shkollat tjera.

z. Bekim Koxha, Në shkollën e Koxhaj nuk kam marrë asnjë përgjigje për një projekt të cilin është thënë se do ta dërgojmë në ministri. Edhe për shkollën e Kovaqecit e kam pasur një kërkesë, por nuk kam marrë përgjigje. Kërkoj përgjigje me shkrim përse janë ndërprerë punimet në atë shkollë kompanisë e cila ka qenë duke i zhvilluar punimet.

z. Zahir Doda, Të çështja e mësimi të kombinuar, është në plan nga ministria që të hiqet kjo formë e mësimi. Nuk ka klasë të kombinuar, sivjet kemi në shkollën e Kotlinës një klasë e kombinuar. Të Çështja e shpenzimeve për shkollën e Kovaqecit, në mbledhjen vijuese do të sjellim një përgjigje. Të Gjimnazi “Skënderbeu” është bërë një shpenzim kapital, operatori i ka kryer punimet, por problemi është diku tjetër- të kompania e cila i ka marrë shtrimin e dyshemeve. Me vjen mirë që edhe Selim Reka foli mirë dhe ma lehtësoj pak çështjen e problemeve lidhur me kryesin e punimeve në këtë shkollë.

z. Nexhat Loku, Ne kemi qenë se bashku në f. Laç, ajo pjesë është me Komunën e Kaçanikut, ndërsa nxënësit shkojnë në shkollat e Hanit të Elezit, kjo është arsyeja që është zvogëluar numri i nxënësve në shkollën e Kotlinës.

z. Adnan Reka, Lidhur me Kërkesën për çështjen e tërheqjes së operatorit në shkollën e Kovaqecit, kërkoj të di se kujt me iu drejtuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Për çështjen e tërheqjes së operatorit në shkollën e Kovaqecit, z. Adnan drejtoju Zyrës së Prokurimit.

Kryetari i Komunës, Është e vërtetë se disa probleme na përcjellën nganjëherë, si çështja tërheqjes së operatorit lidhur me punimet e shkollës së Kovaqecit. Të kjo shkollë punimet

operatori i ka filluar me kohë, por kur ka ardhur të çmimi i dritarëve, ai ka hyrë me çmim shumë të ulët, kështu nuk ka pasur llogari dhe është tërhequr, ndërkaq mjete ka marrë vetëm aq sa ka punuar. Për çështje korruptive që u potencuan, nëse ka diçka në këtë drejtim është mirë me treguar, sepse janë organet kompetente të cilat merren me këtë punë.

Kryetari i Komunës, Kontrata për shkollën e f. Kovaçec, është ndërprerë përmes Zyrtarit të Prokurimit, ndërkaq në listë të zezë nuk kemi mundur me futur kompaninë, ndërkaq iu njoftoj se kompania ka marrë mjete aq sa ka punuar. Shqetësimet z. Adnan lidhur me projektin e shkollës së Kovaçecit, mund t'i ngriti në Zyrën e Prokurimit.

Meqë nuk ka diçka tjetër në këtë çështje, atëherë kjo Informatë nuk del në votim, kështu konstatoj se.

Informata ishte sa për Njoftimin e Kuvendit të Komunës se si ka filluar viti shkollor 2018/2019 / Lënda: 01Nr.61/01-31047/18.

Ndërkaq në fund Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli e njoftoj kuvendin me një Kërkesë të Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), të cilët kanë kërkuar me mbajtur një takim në Komunën e Kaçanikut. Takimi do të mbahet nga datat 1-6 Tetor. Unë kam menduar nëse ju pajtoheni, takimi të mbahet me 5 Tetor në ora 10:00. Në atë takim do të ligjeronjë disa ekspertë të sigurisë, ndërkaq pas takimit është një drekë e përbashket, organizuar nga SPRC.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:47 Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfite Malsiu
Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli
Kemal Mërseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2018, mbajtur me 27 Shtator 2018.

1. Kemal Mërseli..... _____,
2. Hamid Guri..... _____,
3. Ahmet Luma _____,
4. Kadri Krivenjeva,..... _____,
5. Besim Vishi,..... _____,
6. Sali Malsiu..... _____,
7. Lirije Shurdhani..... _____,
8. Pranverë Loku- Zharku..... _____,
9. Lirije Luta..... _____,
10. Vlora Dalloshi..... _____,
11. Nexhat Loku _____,
12. Shpend Krusha..... _____,
13. Adnan Reka..... _____,
14. Ekrem Kyçyku..... _____,
15. Fatijona Kyçyku..... _____,
16. Kaltrina Tafili _____,
17. Selim Reka..... _____,
18. Besnik Salihu,..... _____,
19. Nazife Krasniqi..... _____,
20. Arlinda Rakoci-Raka..... _____,
21. Shemsedin Luzha..... _____,
22. Albana Troni..... _____,
23. Afërdita Shehi,..... _____,
24. Hajredin Luta..... _____,
25. Hafize Sallahi _____,
26. Bekim Koxha..... _____,
27. Ekrem Raka,..... _____,